

VENDIM
Nr.295, datë 6.5.2005

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE
TË KURIMIT TË ZNJ.XHEMILE KUKA, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të znj. Xhemile Kuka, në Turqi.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano